



НУЦК „ИЉО АНТЕСКИ-СМОК“ - ТЕТОВО
INQK “ILO ANTESKI-SMOK” - TETOVË
NISC “ILO ANTESKI-SMOK” - TETOVO

RAPORTI VJETOR

PËR PUNË DHE PUNËN
FINANCIARE

2022

TETOVË, 2023

Në bazë të nenit 31-b, paragrafi (1) i Ligjit për Kulturë (“Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 44/2014) dhe nenit 12, pika 10 e Statutit të INQK “Ilo Anteski Smok”-Tetovë, nr. 0101-18/6 miratuar më datë 16.04.2015, Drejtori i Institucionit Nacional Qendra për kulturë “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, paraqet:

**RAPORT VJETOR PËR PUNË DHE PUNËN FINANCIARE TË
INSTITUCIONIT NACIONAL QENDRA PËR KULTURË
”ILO ANTESKI-SMOK”-TETOVË
PËR PERIUDHËN 01.01.2022-31.12.2022**

**TETOVË
2023**

Përmbajtja:

Hyrje.....	4
I. Organet udhëheqëse dhe drejtuese.....	5
I.1. Organ udhëheqës	5
I.2. Organ drejtues.....	5
II. Pagesa të realizuara dhe boxhe të shlyera.....	6
II.1. Dhënie me qira të hapësirave afariste me prokurorim publik elektronik	6
III. Pjesa programore.....	7
III.1. Aktivitetet.....	7
III.2. Raport narativ.....	9
IV. Raporti financiar	17
Përfundimi	21

HYRJE

Qendra për Kulturë „Ilo Anteski-Smok”-Tetovë është ndërtuar në vitin 1973, ndërsa administrata zyrtarisht me punë filloi në vitin 1975. Objekti ka sipërfaqe prej 6500 m², nga e cila 780 m² janë pjesë e skenës.

Për organizim të aktiviteteve skenike, Qendra për kulturë posedon sallë të madhe me 661 ulëse, si dhe sallë të vogël me 50 ulëse për promovime të ndryshme.

Qendra për kulturë është institucion i rëndësishëm për kulturën, aktivitetet kulturore dhe skenike, të cilat realizohen në qytetin e Tetovës dhe rrethinën në përgjithësi. E gatshme për organizim të koncerteve, aktiviteteve të ndryshme muzikore dhe skenike, shfaqje, promovime, ekspozita, koncerte të ansambleve, mbajtje të aktiviteteve politike dhe njëkohësisht me veprimet e veta në mënyrë aktive vepron në promovimin dhe realizimin e vlerave kulturore.

Për çdo vit në këtë objekt aktivitetet e tyre i zhvillojnë qindra aktorë të profileve të ndryshme nga të gjitha nacionalitetet dhe gjuhë të ndryshme, aktorë, muzikantë, këngëtarë, kore, fotograf. Në qendrën për kulturë në vit organizohen mbi 100 aktivitete me mbi 50.000 vizitorë.

I.ORGANET UDHËHEQËSE DHE DREJTUESE

I.1. ORGAN UDHËHEQËS DREJTORI

Institucioni Nacional qendra për kulturë “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, udhëhiqet nga drejtori. Drejtorin e zgjedh ministri i kulturës me konkurs publik të shpallur nga Ministria e Kulturës dhe me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Drejtori i institucionit për periudhën nga 01.01.2022-31.12.2022 vit, ka udhëhequr, koordinuar dhe ka eliminuar të gjitha pengesat e mundshme, për realizim efikas të aktiviteteve amë, aktiviteteve që organizohen nga shoqata si dhe institucione të ndryshme.

I.2. ORGAN DREJTUES KËSHILLI DREJTUES

Këshillin drejtues të Qendrës për kulturë e përbëjnë 5 (pesë) anëtarë të cilët i emëron dhe shkarkon ministri i kulturës, nga të cilët dy janë nga radha e përfaqësuesve nga sfera e kulturës, një është nga pushteti vetë administrimit lokal dhe dy përfaqësues nga të punësuarit në Qendrën për kulturë. Këshilli Drejtues në periudhën nga 01.01.2022-31.12.2022 vit, ka realizuar gjithësej tetë (8) seanca, të dhëna në mënyrë tabelore.

Data e seancave	Vendime	Pëlqime	Miratime
25.01.2022	/	/	1
02.03.2022	/	/	3
25.03.2022	/	/	1
01.06.2022	/	1	/
29.06.2022	/	/	1
21.07.2022	/	/	4
27.07.2022	1	/	1
02.12.2022	1	/	1
Gjithsej:	2	1	12

II. PAGESA TË REALIZUARA DHE BORXHE TË SHLYERA

INQK “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, në lidhje me procedurat përmbarese për periudhën nga 01.01.2022-31.12.2022, nuk ka realizuar asnjë pagesë apo borxh të shlyer përmes procedurave përmbarese.

II.1. DHËNIE ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE ME PROKURIM PUBLIK ELEKTRONIK

INQK “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, më datë 20.04.2022, në gazetën ditore Lajm dhe Nova Makedonija, publikoi thirrjen publike për dhënie me qira të hapësirave afariste në procedurë elektronike në web faqen www.deloven-prostor.mk, me afat aplikimi prej 10 ditëve nga dita e publikimit të thirrjes publike. Në shpalljen publike për lokalin afarist me nr. rednor 1 me çmim fillestarë të qirasë mujore prej 34.999,00 pa TVSH, është paraqitur një ofertues:

1. Personi juridik shoqëria tregtare, Tregtarë individual, Tregti me pakicë FI-GA JUNIOR TI Samid Gafur Abdii - Tetovë.

Nga prokurimi publik elektronik i realizuar më datë 05.05.2022 me fillim në ora 10:00 dhe përfundim në ora 11:16:12 dhe në pajtim me raportin e Aukcionit nr.1316/9375 për ofertues më i volitshëm, për hapësirën afariste me numër rendor 1, që paraqet pjesë PK 2189, pjesa 1, fletëpronësi nr.101858, Parcela Komunale Tetovë-1, numër i ndërtesës 1, hyrje 1, kat 1 përdhësë, hapësirë afariste me hapësirë gjithësej 14 m², është **zgjedhur** Shoqëria tregtare, Tregtarë individual, Tregti me pakicë FI-GA JUNIOR TI Samid Gafur Abdii – Tetovë, me ofertë përfundimtare prej **24,499.00 denarë pa TVSH**. Me ofertuesin është lidhur kontratë për dhënie me qira të hapësirës afariste në afat prej 5 vitesh.

III. PJESA PROGRAMORE

III.1. AKTIVITETET

INQK “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, në objektin e vet për paraqitje të aktiviteteve të ndryshme ka sallën e madhe me kapacitet prej 661 ulësesh, sallën e vogël dhe sallën në Aneksin-C, të përshtatshme për promovime të ndryshme me 50 ulëse.

Në periudhën prej 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në Qendrën për kulturë, gjithsej janë realizuar 50 aktivitete të ndryshme, nga të cilat shumica janë të veprimtarisë së dramës dhe muzikës. Në këto aktivitete, në Qendrën për Kulturë kanë frekuentuar 27.930 dashamirë të artit të të gjitha kombësive dhe religjioneve në vend.

Sallën e madhe të Qendrës për Kulturë proporcionalisht e shfrytëzon edhe Teatri i Tetovës, edhe atë çdo të enjte dhe të premte gjatë vitit, si dhe termine të tjera para realizimit të premierave, ndërsa gjithsej për këtë periudhë e kanë shfrytëzuar për 39 ditë.

Aktivitetet të ndara sipas llojit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 në mënyrë tabelare duket kështu:

NR.	LLOJI I AKTIVITETIT	NUMRI I AKTIVITETEVE
1.	Shfaqje	13
2.	Muzikë klasike dhe balet	2
3.	Folklor	11
4.	Ekspozita	2
5.	Panairë	
6.	Tribuna	5
7.	Takime politike	5
8.	Muzikë argëtuese	1
9.	Aktivitete për fëmijë	6
10.	Aktivitete humanitare	
11.	Film	2
12.	Veprimtari letrare	3
	Gjithsej	50

Sipas kategorisë së moshës:

Nr.	Kategoria e moshës	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	deri 12	8	4.650
2.	+12	3	2.550
3.	+18	39	20.730
	Gjithsej	50	27.930

Aktivitete sipas bazës nacionale:

Nr.	Aktivitet sipas përkatësisë nacionale	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	E përzier	9	6.280
2.	Shqiptare	25	13.850
3.	Maqedonase	14	6.500
4.	Serbe	1	650
5.	Turke	1	650
6.	Rome	0	0
	Gjithsej	50	27.930

Qendra për Kulturë ka të lidhur kontrata me të gjithë organizatorët, përveç Teatrit të Tetovës, me të cilët jemi nën një kulm.

III.2. RAPORT NARATIV

Janar 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Tribunë	DAP	5.01.2022	30

01) 05.01.2022 (e mërkurë) – Në sallën e vogël u realizua një takim i përfaqësuesve të DAP-it. Në takim pati 30 të pranishëm.

Mars 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Folklor	Qendra e Kulturës	7.03.2022	600
Shfaqje	Teatri i Tetovës	19.03.2022	450
Takim Politik	Aleanca për shqiptarët	27.03.2022	650

- 01) 07.03.2022 (e hënë) – Në organizim të Qendrës për Kulturë “Ilo Anteski-Smok”, në sallën e madhe me rastin e 7-marsit ditës së arsimit shqip, në bashkëpunim me Shoqatën e pedagogëve shqiptarë u organizua një akademi solemne dhe koncert vjetor me këngëtarë dhe valltarë. Në aktivitet pati 600 të pranishëm.
- 02) 19.03.2022 (e shtunë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës, u dha repriza e shfaqjes “Të mallkuarit”, në regji të Gent Çajanit. Në aktivitet pati 450 të pranishëm.
- 03) 27.03.2022 (e diel) – Në organizim të Aleancës për shqiptarët, u organizua kongresi i partisë. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.

Prill 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Tribunë	Studio e dramës	20.04.2022	100
Folklor	Qendra e Kulturës	29.04.2022	650

- 01) 20.04.2022 (e mërkurë) – Në organizim të Studios së Dramës, u mbajt tribunë me rastin e vdekjes së aktorit tetovar Miodrag Nikoliq – Panta. Në aktivitet pati 100 të pranishëm
- 02) 29.04.2022 (e premte) - Tetova pati rastin që këtë ditë të veçantë, ditën ndërkombëtare të vallëzimit, në organizim të Qendrës për Kulturë, në një atmosferë të ngrohtë t'i ndjekë vëllezërit dhe motrat tona të Ansamblit kombëtar të këngëve dhe valleve të Republikës së Shqipërisë. Ata para publikut tetovar fluturuan si shqiponja të vërteta, që me profesionalizmin e tyre dëshmuuan se folklori shqiptar përcillet brez pas brezi. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Letërsi	INB “Koço Racin”	06.05.2022	350
Shfaqje	Teatri i Tetovës	13-14.05.2022	150
Shfaqje	Leteçka teatarska trupa	17-18.05.2022	1.200
Ekspozitë	INQK. “Ilo Anteski-Smok”	20.05.2022	50
Folklor	Shoqata “I.A.-Smok”	21.05.2022	200

Maj 2022

- 01) 06.05.2022 (e premte) –Në Qendrën për Kulturë, në organizim të IN Biblioteka “Koço Racin” – Tetovë, u bë ndarja e çmimeve për fituesit e konkursit letrar për poezi dhe prozë më të mirë. Në aktivitet morën pjesë 350 pjesëmarrës.
- 02) 13-14.05.2022 (e premte-e shtunë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës u realizua shfaqja kamertale “Veshkët”, të autorit Shtefan Fogel dhe në regji të Marijan Gjeorgjevski. Në para premierë dhe premierë gjithsej pati 150 të pranishëm.
- 03) 17-18.05.2022 (e martë – e mërkurë) – Në organizim të Leteçka Teatarska Trupa, në sallën e madhe u realizua pjesa teatrale për fëmijë “Trnorushka” në regji të Vladimir Jovanovskit. Shfaqja u realizua dy ditë në dy terminë, ndërsa shfaqjen e ndoqën 1.200 artdashës.
- 04) 20.05.2022 (e premte) – Në organizim të INQK. “Ilo Anteski-Smok” dhe në mbështetje të Ministrisë së Kulturës, u mbajt ekspozita personale e Aneta Hasanit me titull “Portrete të kohës”. Në aktivitet pati 50 të pranishëm.
- 05) 21.05.2022 (e shtunë) – Në organizim të Shoqatës “Ilo Anteski-Smok” – Tetovë, u mbajt Festivali Ndërkombëtar i Folklorit, në të cilën morën pjesë mysafirë nga rajoni. Në aktivitet pati 200 të pranishëm,

Qershor 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Aktivitet për fëmijë	Çerdhja Mlladost	01.06.2022	650
Aktivitet për fëmijë	Festivali “Jabollçinja”	04.06.2022	300
Shfaqje	Leteçka Teatarska Trupa	07-08.06.2022	900
Folklor	Ansambli Tanec	09.06.2022	300
Shfaqje	Teatri i Tetovës	16-17.06.2022	1.000
Aktivitet për fëmijë	Balet “Menada”	18.06.2022	650
Ekspozitë	INQK “I.A.-Smok”	20.06.2022	100
Muzikë klasike dhe balet	INQK “I.A.-Smok”	24.06.2022	300
Shfaqje	Teatri i Tetovës	29.06.2022	150

- 01) 01.06.2022 (e mërkurë) - Në organizim të çerdhes “Mlladost”, në sallën e madhe u mbajt program vjetor me performancë të fëmijëve të vegjël, që performuan lojëra dhe këngë. Në aktivitet pati 650 vizitorë.
- 02) 04.06.2022 (e shtunë) - Në sallën e madhe u mbajt festivali për fëmijë “Jabollçinja”, në të cilën kënduan 15 fëmijë. Në aktivitet pati 300 vizitorë.
- 03) 07-08.06.2022 (e martë - e mërkurë) - Në organizim të Leteçka teatarska trupa, në sallën e madhe u realizua shfaqja për fëmijë “Lufta e fundit” në regji të Vlladimir Jovanovskit. Shfaqja u realizua dy ditë me nga dy termine, ndërkaq në aktivitet pati 900 të pranishëm.
- 04) 09.06.2022 (e enjte) – Në organizim të Ansambllit “Tanec”, në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës, para publikut tetovar u mbajt koncert vjetor, ku me paraqitjen mahnitën valltarët dhe siolistët. Në aktivitet pati 300 vizitorë.
- 05) 16-17.06.2022 (e enjte – e premte) – Në organizim të Teatrit të Tetovës, në sallën e madhe u realizua premiera dhe repriza e shfaqjes “Borgjezi fisnik”, në regji të Kushtrim Bektshit. Në aktivitet ishin të pranishëm 1.000 artdashës.
- 06) 18.06.2022 (e shtunë) - Në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë në Tetovë, në organizim të Studios së baletit “Menada” u mbajt mbrëmje baleti me fëmijë. Në aktivitet ishin të pranishëm 650 artdashës.

- 07) 20.06.2022 (e hënë) - Në organizim të INQK “Ilo Anteski-Smok”, a mbështetur nga Ministria e Kulturës, u mbajt ekspozita personale e piktorit Gëzim Azemi, me titull “Klasik – 2”. Në ekspozitë pati 100 të pranishëm.
- 08) 24.06.2022 (e premte) - Në organizim të INQK “Ilo Anteski-Smok”, a mbështetur nga Ministria e Kulturës, u mbajt mbrëmje klasike me paraqitje të orkestrës që dirigjohet nga dirigjenti i njohur tetovar Premtim Etemi, me titull “Tingujt e filmit”. Në aktivitet pati 300 të pranishëm.
- 09) 29.06.2022 (e premte) - Në organizim të Teatrit të Tetovës, në sallën e madhe u realizua repriza e shfaqjes “Borgjezi fisnik”, në regji të Kushtrim Bekteshit. Në aktivitet pati 150 të pranishëm.

Korrik 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Takime politike	PDSH	07.07.2022	650

- 01) 07.07.2022 (E enjte) – PDSH organizoi Kongresin e 8-të të partisë. Në aktivitet pati 650 delegatë.

Gusht 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Takime politike	PDSH	18.08.2022	650
Film	TIFF Oda	26-31.08.2022	2.000

- 01) 18.08.2022 (E enjte) – PDSH mbajti mitingun përmbyllës para zgjedhjeve lokale për këshilltarë të Komunës së Tetovës. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 02) 26-31.08.2022 (E premte- e mërkurë) – Në Festivalin ndërkombëtar të Filmit në Tetovë “TIFF ODA 2022”, që u mbajt në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë u realizuan 51 filma. Në aktivitet kishte 2.000 të pranishëm.

Shtator 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Folklor	Shoqëria maqedono-kroate	9.09.2022	300
Shfaqje	Skupi fest	9,13,14.09.2022	1.000
Folklor	SHKA “Branko Çajka”	23.09.2022	650

- 01) 09.09.2022 (E premte) – Në organizim të Shoqërisë maqedono-kroate, u mbajt koncert i folklorit me pjesëmarrje të shoqërive prej Kroacie dhe Maqedonisë së Veriut. Në aktivitet pati 300 të pranishëm.
- 02) 09,13,14.09.2022 (E premte, e martë, e mërkurë) – Në organizim të Skupi festi, u mbajt festival i teatrove. Shfaqjet që u realizuan ishin me mysafirë nga Shqipëria, Italia dhe Kosova. Në ngjarje pati 1.000 të pranishëm.
- 03) 23.09.2022 (E shtunë) – Në organizim të SHKA “Branko Çajka”, në sallën e madhe të Qendrës për kulturë u mbajt një koncert solemn me këngë dhe valle. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.

Tetor 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Letërsi	Shoqata “Oeneum”	01.10.2022	100
Muzikë klasike dhe balet	Konsonanca	01.10.2022	50
Tribunë	SHKA “Xheladin Zeqiri”	07.10.2022	50
Folklor	INQK “I.A.-Smok”	08.10.2022	650
Shfaqje	Teatri i Tetovës	15,21,29.10.2022	1.500
Letërsi	“Ditët e Naimit”	20.10.2022	300
Folklor	SHKA “Izvor” – Jegunovcë	22.10.2022	350

- 01) 01.10.2022 (E shtunë) – Në organizim të Shoqatës “Oeneum” – Tetovë, u organizua promovimi i librit të poeteshës Merita Abazi me titull “Imagjinata e endacakes”. Në aktivitet pati 100 të pranishëm.

- 02) 01.10.2022 (E shtunë) – Në organizim të Shoqatës “Konsonanca”, u organizua një koncert klasik me orkestër dhe solistë, nën dirigjimin e Agona Çupit. Në aktivitet pati 50 të pranishëm.
- 03) 07.10.2022 (e premte) – Në organizim të INQK “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë dhe SHKA “Xheladin Zeqiri”, u mbajt tribuna me temë: Këngët e vjetra qytetare në rajon. Në aktivitet pati 50 të pranishëm.
- 04) 08.10.2022 (e shtunë) – Në organizim të INQK “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, në mbështetje të Ministrisë së Kulturës, u mbajt edicioni i 11-të i Festivalit të Këngëve të vjetra qytetare “Teuta”. Në këtë festival performuan grupe nga Tetova, Gostivari, Elbasani, Prishtina dhe Ferizaji. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 05) 15, 21, 29 tetor 2022 (e shtunë, e premte, e shtunë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës u realizua premiera dhe repriza e shfaqjes “Armiku i popullit” nga Henrik Ibsen, me regji të Arben Kumburos. Në shfaqje pati 1500 të pranishëm.
- 06) 20.10.2022 (e enjte) – Në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës u mbajt Manifestim Letrar Ndërkombëtar “Ditët e Naimit”. Në këtë aktivitet morën pjesë 30 poetë nga vendi dhe bota. Aktivitetin e ndoqën 300 vizitorë.
- 07) 22.10.2022 (e shtunë) – Në sallën e madhe u mbajt koncert folklorik në organizim të SHKA “Izvor” – Jegunovcë. Në aktivitet pati 350 të pranishëm.

Nëntor 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	Teatri “Pinokio”	04,09,11.11.2022	1.200
Shfaqje	Teatri i Tetovës	10,16.11.2022	1.000
Film	Banana film	17,21.11.2022	300
Tribunë	Aleanca e luftëtarëve	18.11.2022	650
Muzikë zbavitëse	Trio Sherbet	19.11.2022	650
Tribunë	Komuna e Tetovës	22.11.2022	650
Shfaqje	Komuna e Tetovës	23.11.2022	300
Politikë	LSDM	25.11.2022	650
Folklor	SHKA “Xheladin Zeqiri”	26.11.2022	650
Aktivitet për fëmijë	SHF. “Istikball”	28.11.2022	650
Folklor	INQK. “I.A.-Smok”	28.11.2022	650

- 01) 04,09,11.11.2022 (e premte, e mërkurë, e premte)- Në sallën e madhe, Teatri për fëmijë “Pinokio”, mbajti shfaqje për fëmijë „Kësulëkuqja në udhëkryq”, për nxënësit e shkollave fillore. Në aktivitetet pati gjithsej 1.200 të pranishëm.
- 02) 10,16.11.2022 (e enjte, e mërkurë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës, u realizuan reprizat e shfaqjes “Armiku i popullit”, autor Henrik Ibsen, në regji të Arben Kumbaro. Në ngjarjet morën pjesë 1.000 të pranishëm.
- 03) 17,21.11.2022 (e enjte, e hënë) - Në organizim të produksionit të filmit “Banana film”, u shfaq filmi “Kajmak” i regjisorit Millço Mançevski. Në aktivitet pati 300 të pranishëm.
- 04) 18.11.2022 (e premte) – Në organizim të Aleancës së luftëtarëve u organizua tribunë me rastin e çlirimit të Tetovës. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 05) 19.11.2022 (e shtunë) – Në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës, u mbajt një koncert më këngë qytetare nga trio grupi i mirënjohur tetovar “Sherbet”. Në ngjarje pati 650 të pranishëm.
- 06) 22.11.2022 (e martë) – Në organizim të Komunës së Tetovës dhe Shoqatës së Pedagogëve shqiptarë, u mbajt tribunë me rastin e ditës së alfabetit shqip. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 07) 23.11.2022 (e mërkurë) – Në organizim të Komunës së Tetovës u mbajt shfaqja komedi “1X2”. Në ngjarje pati 300 të pranishëm.
- 08) 25.11.2022 (e premte) - Në organizim të LSDM në sallën e madhe u mbajt tribunë. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 09) 26.11.2022 (e shtunë) – Në organizim të komunës së Tetovës u mbajt Koncert vjetor, në bashkëpunim me SHKA “Xheladin Zeqiri”. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 10) 28.11.2022 (e hënë) – Në organizim të SHF “Istikball”, nxënësit e kësaj shkolle shfaqën më shumë aktivitete kulturore. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 11) 28.11.2022 (e hënë) – Në organizim të Qendrës për kulturë, me rastin e Ditës së pavarësisë, mbajtën koncert me anëtarët e veprimtarisë së folklorit të Qendrës së kulturës. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.

Dhjetor 2022

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Aktivitet për fëmijë	Bletëzat	1.12.2022	650
Shfaqje	“Dramsko Studio”	16.12.2022	650
Aktivitet për fëmijë	Komuna e Tetovës	17.12.2022	650
Shfaqje	SHK. “I.A.-Smok”	22.12.2022	300

Folklor	SHKA. “Kiril Pejčinović”	23.12.2022	650
Takime politike	Aleanca për shqiptarët	24.12.2022	650

- 01) 01.12.2022 (e enjte) – Në sallën e madhe u mbajt festivali tradicional për fëmijë “Bletëzat”. Gjithsej pati 15 këngë të interpretuar nga fëmijët, ndërsa në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 02) 16.12.2022 (e premte) – Në organizim të Dramsko Studio, u mbajt shfaqja tradicionale “I tetovskite gllumci poa” – edicioni i 8-të. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.
- 03) 17.12.2022 (e shtunë) – Në organizim të Komunës së Tetovës, u shënua dita e arsimit turk. Në ngjarje morën pjesë fëmijët e paraleleve turke të rajonit të Tetovës. Në ngjarje pati 650 të pranishëm.
- 04) 22.12.2022 (e enjte) – Në organizim të Shoqatës për kulturë “Ilo Anteski-Smok” u mbajt shfaqja “Vetëvrasje në vetëmbrojtje”, me mysafirë nga teatri alternativ “Të fshirë” nga Shkupi. Në aktivitet pati 300 të pranishëm.
- 05) 23.12.2022 (e premte) – SHKA “Kiril Pejčinović” nga fshati Tearcë, mbajti koncert vjetor me paraqitje të nikoqirëve por edhe me mysafirë “Trio kladenec”, “Sherbet”, kori i grave “Menada”. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 06) 24.12.2022 (e shtunë) – Aleanca për shqiptarët kishte kongres të rregullt të partisë. Në aktivitet pati 650 të pranishëm.

IV. RAPORTI FINANCIAR

Peruidha prej 01.01.2022 deri më 31.12.2022

TË DALAT, ZËRI 401 - RROGA BAZË

Të punësuarit të cilët me aktivitetin e tyre kontribuojnë për realizimin e programit vjetor të institucionit, vlera për pagat dhe tatimin personal është 10,855,585.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 402 – KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË

Detyrimet të cilat rrjedhin nga pagesa e borxheve kundrejt puntorëve për kontributet janë në vlerën gjithsej 4,221,624.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 421 – SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI

Shpenzimet e Qendrës për Kulturë të energjisë elektrike për 6500 m² të hapsirë shfrytëzuese, dhe atë që e shfrytëzon infrastruktura dhe institucionet e tjera si: Teatri i Tetovës, Këndi Amerikan (American Corner Tetovo) janë në vlerë gjithsej 1,300,000.00 denarë. Shpenzimet për energji elektrike, ujësjellësi dhe kanalizimi, taksa dhe shërbime tjera komunale, materiale tjera për nxemje, posta, telefon, janë gjithsej në vlerë prej 2,373,471.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 423 – MATERIALET DHE INVENTARI I IMËT

Në kategorinë e shpenzimeve të realizuara për materialet dhe inventarin e imët janë kalkuluar lloje dhe sasi materialesh të cilët janë të domozdoshme për kryerjen e obligimeve dhe detyrave: produkte ushqimore, materiale tjera për qëllime të veçanta. Shpenzimet e këtij zëri janë në vlerë prej 90,040.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 425 – SHËRBIMET KONTRAKTUESE

Shpenzimet e këtij zëri për shërbime tjera kontraktuese kapin vlerën prej 3,540.00 денари.

TË DALAT, ZËRI 464 – TRANSFERE TË NDRYSHME

Në këtë kategori të shpenzimeve për realizimin e projekteve artistike janë shpenzuar gjithsej 1,050,000.00 denarë. Transfere tjera janë gjithsej në vlerë prej 2,154,413.00 denarë (për realizimin e mbikëqyrjes të projektit „Rekonstruimi i konstruksionit te kulmit-kupolës”, nga xhirrollogaria e mjeteve vetanake, ndaj SH.P.I MG PROEKT shpknj-Shkup janë realizuar gjithsej 17,601.00 denarë (pjesë e faturës) dhe për realizimin e mbikëqyrjes të projektit „Sanimi dhe adaptimi i objektit ose një pjesë të objektit” nga xhirrollogaria e mjeteve vetanake ndaj N.P.N.T.SH. MURATORI janë realizuar gjithsej 13,642.00 denarë (pjesë e faturës)). Shpenzimet materiale kapin vlerën prej 100,000.00 denarë. Vlera gjithsej e këtij zëri është 3,304,413.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 482 – OBJEKTE TË TJERA NDËRTIMORE

Në ciklin e investimeve në të cilin përfshihet institucioni jonë si bartës i ndërtimit të objektit të Institucionit Kombëtarë Teatri dhe Biblioteka e Tetovës, sipas Aneks Kontratës nr. 20-2064/1 me date 31.12.2021, “Faza e dytë për ndërtimin e objektit të ri të teatrit dhe bibliotekës në Tetovë”, në bazë të situacioneve të pranuar, ndaj Grupit të ofertuesve me përfaqësues D.G.T.U.”NB-COMPANY” DOO Tetovë është realizuar vlera prej 144,233,490.00 denarë. Për kryerjen e mbikëqyrjes së “Faza e dytë për ndërtimin e objektit të ri të teatrit dhe bibliotekës në Tetovë” ndaj firmës EOC E.E. DOO Shkup janë shpenzuar gjithsej 1,766,510.00 denarë. Ndaj Drejtorisë për të Ardhura Publike është realizuar vlera prej 100,000,000.00 denarë, pjesë e borxhit kryesorë tatimor të I.N.Q.K., „Ilo Anteski Smok”-Tetovo, borxh tatimor i bartur nga realizimi fazës së parë të Projektit për ndërtimin e objektit të ri të destinuar për Teatër dhe Bibliotekë në Tetovë. Për projektin „Rekonstruimi i konstruksionit te kulmit-kupolës” ndaj SH.N.K.I.T.SH. SMARTKOM INVEST shpknj-Shkup janë realizuar gjithsej 2,881,021.00 denarë, ndërsa për mbikëqyrje për të njëjtin projekt ndaj SH.P.I MG PROEKT shpknj-Shkup janë realizuar gjithsej 18,979.00 denarë (pjesë e faturës). Për realizimin e projektit „Sanimi dhe adaptimi i objektit ose një pjesë të objektit” ndaj SH.N.K.I.T.SH. SMARTKOM INVEST shpknj-Shkup janë shpenzuar gjithsej 2,406,782.00 denarë, ndërsa për të njëjtin projekt për realizimin e mbikëqyrjes ndaj N.P.N.T.SH. MURATORI janë shpenzuar gjithsej 18,218.00 denarë (pjesë e faturës). Vlera gjithsej e kësaj kategorie të shpenzimeve është 251,325,000.00 denarë.

Bashkangjitje: Paraqitja tabelare e Raportit financiar të I.N.Q.K „Ilo Anteski-Smok”

I. TË HYRAT

ZËRI	PËRSHKRIMI I ZËRIT	VLERA (DENARË) ZËRI 603	VLERA (DENARË) ZËRI 631	VLERA (DENARË) ZËRI 787	VLERA (DENARË) ZËRI 785	GJITHSEJ
723911	Qeraja nga objektet	0,00	608.024,00	547.906,00	0,00	1.155.930,00
741112	Transfere nga buxheti R.M.V.	270.035.815,00	0,00	0,00	0,00	270.035.815,00
741114	Teprica e të ardhurave të bartura nga viti i kaluar	0,00	54.543,00	1.462.397,00	286,00	1.517.226,00
744111	Donacione nga firmat private	0,00	0,00	0,00	28.000,00	28.000,00
	GJITHSEJ TË HYRA	270.035.815,00	662.567,00	2.010.303,00	28.286,00	272.736.971,00

II. TË DALAT

ZËRI	PËRSHKRIMI I ZËRIT	VLERA (DENARË) ZËRI 603	VLERA (DENARË) ZËRI 631	VLERA (DENARË) ZËRI 787	VLERA (DENARË) ZËRI 785	GJITHSEJ
401	RROGA BAZË	10.855.585,00	0.00	0.00	0.00	10.855.585,00
401130	Rroga bazë	10.047.663,00	0.00	0.00	0.00	10.047.663,00
401310	Tatimi personal i të ardhurave të rrogës	807.922,00	0.00	0.00	0.00	807.922,00
402	KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË	4.221.624,00	0.00	0.00	0.00	4.221.624,00
402110	Kontributet bazë të SPI	2.834.506,00	0.00	0.00	0.00	2.834.506,00
402210	Kontributet bazë të shëndetësisë	1.130.790,00	0.00	0.00	0.00	1.130.790,00
402220	Kontributet personale shtesë	75.391,00	0.00	0.00	0.00	75.391,00
402310	Kontributet bazë të entit për punësim	180.937,00	0.00	0.00	0.00	180.937,00
421	SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI	2.268.440,00	66.888,00	38.143,00	0,00	2.373.471,00

421110	Energjia elektrike	1.300.000,00	0,00	0,00	0,00	1.300.000,00
421120	Ujësjetllësi dhe kanalizimi	20.666,00	0,00	0,00	0,00	20.666,00
421190	Taksa dhe shërbime tjera komunale	149.334,00	0,00	0,00	0,00	149.334,00
421290	Materiale tjera për nxemje	798.440,00	0,00	0,00	0,00	798.440,00
421310	Posta	0,00	0,00	14.293,00	0,00	14.293,00
421320	Telefon dhe telefaks	0,00	66.888,00	23.850,00	0,00	90.738,00
423	MATERIALE DHE INVENTARI I IMËT	0.00	90,040.00	0.00	0.00	90,040.00
423410	Produkte ushqimore	0.00	26,103.00	0.00	0.00	26,103.00
423910	Materiale tjera për qëllime të veçanta	0.00	50,700.00	0.00	0.00	50,700.00
423990	Materiale tjera	0.00	13,237.00	0.00	0.00	13,237.00
425	SHËRBIME KONTRAKTUESE	0.00	3,540.00	0.00	0.00	3,540.00
425990	Shërbime tjera kontraktuese	0.00	3,540.00	0.00	0.00	3,540.00
464	TRANSFERE TË NDRYSHME	1,365,166.00	491,358.00	1,424,879.00	23,010.00	3,304,413.00
464990	Transfere tjera	1,365,166.00	491,358.00	1,424,879.00	23,010.00	3,304,413.00
482	OBJEKTET TJERA NDËRTIMORE	251,325,000.00	0.00	0.00	0.00	251,325,000.00
482920	Ndërtimi i objekteve tjera	251,325,000.00	0.00	0.00	0.00	251,325,000.00
GJITHSEJ		270,035,815.00	651,826.00	1,463,022.00	23,010.00	272,173,673.00

I. GJITHSEJ TË HYRA 272,736,971.00

II. GJITHSEJ TË DALA 272,173,673.00

FITIMI NETO I REALIZUAR MBI TË HYRAT 563,298.00

PËRFUNDIMI

Si përmbledhje e gjithçkaje të lartëpërmendur mund të përmend elementet e mëposhtme:

- Periudha prej më 01.01.2022–31.12.2022 Qendra për Kulturë e përfundon me bilans pozitiv të suksesit;
- Planifikimet financiare të shpenzimeve tre mujore te Qendrës për Kulturë nuk janë respektuar plotësisht nga Ministria e Kulturës;
- Të gjendet zgjidhje për menaxhimin reciprok me Teatrin e Tetovës për shpenzimet dhe të hyrat për mirmbajtjen dhe shfrytëzimin e të gjithë infrastrukturës tonë.

Punuar nga:

Artan Arslani, Udhëheqës programor _____

M-r Sheval Sulejmani, Këshilltar për punë të përgjithshme administrative dhe punë juridike _____

Luljeta Shaqiri, Këshilltar për punë materiale financiare _____

Dashnor Agolli, Udhëheqës i Sektorit për punë materiale-financiare dhe kontabilitet _____

INQK “Ilo Anteski-Smok”
Drejtore

M-r Arlind Huseini

